



Planuar / Dorezuar Pratjeno/Pridato Received/Delivered	18.12.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKADYSHICK	7522/2023		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1423/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1423/2023 të datës 20.11.2023 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me numër Ref.02/Nr.381 me numër protokoli 886/03 të datës 08.11.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1423/2023 të datës 20.11.2023 të parashtruar nga ankuesja

II. Shfuqizohet Vendimi me numër Ref.02/Nr.381 me numër protokoli 886/03 i datës 08.11.2023 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

III. Detyrohet Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i formuar sipas Vendimit Ref.02/Nr.296 të datës 14.09.2023, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e zhvilluar procedurën e ngritjes në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Tregti në Shërbime" nga faza e intervistës me gojë e deri në fund të procedurës.

IV. Obligohet Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 17.07.2023 ka publikuar Konkursin me Nr.Reference: RN00012044 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Tregti në Shërbime" në Departamentin e Tregtisë, ku afati për aplikim ka qenë nga data 09.08.2023 deri më datë 16.08.2023, në të cilin konkurs kanë aplikuar gjashtë (6) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja e cila i është nënshtruar fazave të procedurës (verifikimit paraprak, testit me shkrim, vlerësimit të jetëshkrimit).

Më datë 06.11.2023 ankuesja përmes emailit nga B.B është njoftuar se intervista me gojë për këtë pozitë mbahet më datë 08.11.2023 ora 10:15, ndërsa në të njëjtën datë përmes emailit/njoftimit i është drejtuar B.B se kemi pritur deri në orën 10:25 mirëpo komisioni nuk është paraqitur për intervistim.

Meqë nuk është mbajtur intervista me gojë, Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 08.11.2023 ka nxjerr Vendim me numër Ref.02/Nr.381 me numër protokollit 886/03, me të cilin ka bërë anulimin e procedurave të rekrutimit që janë në zhvillim në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me arsyetimin për tejkallim të afateve të procedurës dhe me arsyetimin se ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë dhe Rregullorja (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe se pritet me u zhvilluar procedurat e reja të rekrutimit.

Ankuesja ndaj këtij vendimi, më datë 20.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7026/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.11.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ndërsa kjo fundit më datë 30.11.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7026/2023 të datës 20.11.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Ref.02/Nr.381 me numër protokollit 886/03 të datës 08.11.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Konkursin me Nr. Reference: RN00012044 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Tregti në Shërbime" në Departamentin e Tregtisë; Njoftimin e datës 17.08.2023; Njoftimin nga SIMBNJ i datës 28.08.2023, 26.09.2023 për ankuesen; Emailin e datës 09.10.2023 nga ankuesja për A.D; Emailin e datës 06.11.2023 nga SIMBNJ për ankuesen; CV-në e ankueses; Emailin e datës 06.11.2023 nga B.B për ankuesen; Emailin e datës 08.11.2023 nga ankuesja për B.B; Emailin e datës 08.11.2022 nga B.B për ankuesen; Njoftimin e datës 09.11.2023 për anulim të procedurës;



Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 27.11.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 30.11.2023; Lista e aplikantëve; Njoftimin e datës 28.08.2023; Emailin e datës 06.09.2023 nga A.K për A.D; Emailin e datës 06.09.2023 nga A.D për A.K; Emailin e datës 04.09.2023 nga A.D për B.B; Emailin e datës 28.08.2023 nga N.Sh për B.B dhe F.Z; Vendimin Ref. 02/Nr/.296 i datës 14.09.2023; Emailin e datës 18.09.2023 nga V.R-V për L.H, L.Z dhe G.S; Emailin e datës 18.09.2023, 17.08.2023 nga V.R-V për A.V; Emailin e datës 18.09.2023 nga V.R-V për ankuesen dhe kandidatët tjerë; Emailin e datës 06.11.2023 nga L.H për A.D dhe B.B; Emailin e datës 09.11.2023 nga N.Sh për F.Z dhe Emailin e datës 14.11.2023 nga F.Z për N.Sh.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e bazuar sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Ref.02/Nr.381 me numër protokollit 886/03 të datës 08.11.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Pretendon se ky vendim nuk përmban elementet e aktit administrativ; Preambula e këtij vendimi është jo ligjore sepse në preambulë të këtij vendimi është përmendur neni 60 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë; Arsyetimi i këtij vendimi është jo ligjor dhe nuk ka bazë juridike për anulim të konkursit me arsyetimin se ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë; Vonesat në këtë procedurë kanë qenë të qëllimshme.

Lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji i Këshillit, konstaton se afati për aplikim sipas konkursit me Nr. Reference:RN00012044 për ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Tregti në Shërbime" në Departamentin e Tregtisë, ka qenë nga data 09.08.2023 deri më datë 16.08.2023, ndërsa lista e verifikimit paraprak fillestar është bërë më datë 17.08.2023, ndërsa pas përfundimit të afatit të ankesave në këtë procedurë verifikimin paraprak përfundimtar ka rezultuar të jetë data 28.08.2023 sipas njoftimit të publikuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, mbi këtë bazë lista e verifikimit paraprak është bërë brenda afateve të parashikuar me nenin 45 ndërlidhur me nenin 57 të Rregullores Nr.16/2022 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Në bazë të shkesave të lëndës, testi me shkrim lidhur me këtë pozitë është mbajtur më datë 26.09.2023 nga ora 14:30 me çka rezultoi se sipas njoftimit nga SIMBNJ ankuesja në testin me shkrim është vlerësuar me gjithsej 56 pikë, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton nga faza e vlerësimit përfundimtar paraprak deri në ditën e mbajtjes së testit me shkrim kanë kaluar gati tridhjetë (30) ditë, dhe mbi bazë të provave të lëndës nuk ka asnjë provë të justifikueshme pse janë bërë këto vonesa në zhvillimin e procedurës, si rezultat i kësaj është se kandidatët në procedurë nuk janë njoftuar për çështjet e tilla, kështu që nuk ka pasur transparencë dhe është vepruar në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "1. Organet publike duhet të veprojnë me transparencë. 2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshitatshme, në pajtim me këtë Ligj". Po ashtu Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton se ankuesja përmes emailit të datës 09.10.2023 të dërguar për A.D ka kërkuar se nga data 26.09.2023 nuk ka asnjë informatë lidhur fazat vijuese të procedurës dhe për këtë nuk ka

marr asnjë përgjigje, kurse përmes emailit të datës 06.11.2023 të dërguar nga SIMBNJ për ankuesen rezultoi se vlerësimi i jetëshkrimit është bërë me këtë datë dhe ankuesja në këtë fazë ka marr gjithsej 14 pikë.

Duke marr parasysh faktet mbi bazë të të cilave është vlerësuar ky proces, por duke marr parasysh edhe konstatimet e cekura si më lartë si dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë gjegjësisht Vendimit me numër Ref.02/Nr.381 me numër protokoll 886/03 të datës 08.11.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin e zgjatja e procedurës së ngritjes në detyrë për pozitën "*Udhëheqës i Divizionit për Tregti në Shërbime*", ka qenë e pa justifikueshme ngase ankuesja në mes të fazave të vlerësimit përveç rezultateve nuk është njoftuar për asnjë vonesë dhe arsytet e tyre, me çka dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se kur vonesat në procedurë administrative bëhen të pajustificueshme dhe se këto vonesat varen nga institucioni me qëllim të arrihet në një përfundim për anulimin e procedurave për qëllime të tilla, janë veprime të dëmshme për palët në procedurë, kështu që në këtë rast nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 98 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative për anulimin e procedurës për shkak të tejkalimit të afateve ligjore, ngase ky nen përcakton se afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj por jo kur procedura zgjatet qëllimisht dhe pa arsye, sepse Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i formuar sipas Vendimit Re.02/Nr.296 të datës 14.09.2023 në momentin që do të kishte konstatuar se kjo procedurë nuk mund të përfundojë brenda afatit prej 45 ditësh si afat i rregull dhe i arsyeshëm, atëherë për arsye të çështjeve komplekse ka mundur të aplikojë nenin 99 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e që në rastin konkret nuk është vepruar, kështu që edhe pretendimi i ankueses se vonesat në këtë procedurë kanë qenë të qëllimshme, është i bazuar, ndërsa arsyetimi i vendimit të kundërshtuar në këtë pikë nuk ka mbështetje ligjore.

Kolegji i Këshillit, sa i përket shqyrtimit të vendimit të kundërshtuar me ankesë në pikat e tjera konstaton se Vendimi me numër Ref.02/Nr.381 me numër protokoll 886/03 i datës 08.11.2023 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, është nxjerr në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht i njëjti nuk përmban në mënyrë të saktë elementet e aktit administrativ, të parashikuara me nenin 47, sepse në pjesën hyrëse (preambulë) përveç tjerash baza e vendimmarrjes mbështet në nenin 60 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, ndërsa ky nen ka të bëjë me krijimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor, pjesa urdhëruese (dispozitivi) i këtij vendimi është i paqartë, ngase thekson se Anulohen procedurat e rekrutimit që janë në zhvillim në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ndërsa nuk jep arsytetime konkrete siç e parasheh nën paragrafi 1.2 i këtij neni, pjesa arsyetuese, siç e theksuam më lartë në këtë vendim nuk ka mbështetje ligjore, kurse ky vendim nuk përmban as pjesën përmbyllëse (këshillën juridike) ku palët e pakënaqura me këtë akt, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi i ankueses se ky vendim nuk përmban elementet e aktit administrative dhe preambula e këtij vendimi është jo ligjore sepse në

preambulë të këtij vendimi është përmendur neni 60 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është i bazuar.

Lidhur me pjesën tjetër të arsytimit të Vendimit me numër Ref.02/Nr.381 me numër protokoli 886/03 të datës 08.11.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e që ka të bëjë me datën se anulimi i procedurave është bërë edhe për arsyet se ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullorja (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil dhe se pritet me u zhvilluar procedurat e reja të rekrutimit, Kolegji i Këshillit, sjell në vëmendje se Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë është publikuar në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 18.09.2023 ndërsa ky ligj ka hy në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës siç parashihet me nenin 105 të këtij ligji, ndërsa sipas nenit 99 paragrafi 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: "6. Procedurat e rekrutimit, të disiplinës apo të ankesave të filluara dhe të papërfunduara në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë sipas dispozitave të mëparshme ligjore, që kanë rregulluar çështjet përkatëse. 7. Hyrja në fuqi e këtij ligji përbën shkas për përfundimin e mandatit të komisioneve të themeluara në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik. Në rast se këto komisione kanë në shqyrtim procedura të rekrutimit, të disiplinës apo të ankesave, duhet të përfundojnë këto procedura, dhe më pas konsiderohet se përfundon mandati i tyre", rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, marr parasysh që procedura e ngritjes (avancim) në detyrë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Tregti në Shërbime" në Departamentin e Tregtisë sipas konkursit me Nr. Reference:RN00012044 ka filluar para se të hyjë në fuqi ky ligj, atëherë mbi bazën ligjore të theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se i tërë procesi i këtij konkursi duhet të bëhet në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren e aplikuar në këtë periudhë Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës dhe nuk ka asnjë bazë juridike për anulim të konkursit mbi bazë të një arsytimi siç është theksuar në vendimin e kundërshtuar, kështu që pretendimi i ankesës se arsytimi i këtij vendimi është jo ligjor dhe nuk ka bazë juridike për anulim të konkursit me arsytimin se ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë është i bazuar.

Nga konstatimet si më lartë e që ndërlidhen me ligjshmërinë e Vendimit me numër Ref.02/Nr.381 me numër protokoli 886/03 të datës 08.11.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është në kundërshtim me nenin 47, nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 99 paragrafi 6 dhe 7 të Ligjit aktual Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dispozitave të Ligjit (të aplikuar në kohën e shpalljes së këtij konkursi) Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si rezultat i këtyre shkeljeve ky akt është i pavlefshëm në kuptim të nënti 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-051 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase me këtë vendim janë shkelur parimet e ligjshmërisë të parapara me nenin 4 të këtij ligji dhe për rrjedhojë më këtë vendim është cenuar parimi i sigurisë juridike të palëve, andaj për arsytimet e tilla ky vendim është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në at që u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale të potencuara si më lartë në këtë procedurë, atëherë dhe me qëllim të eliminimit të tyre, Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i formuar sipas Vendimit

Ref.02/Nr.296 të datës 14.09.2023, është i detyruar që të zhvillojë procedurën e ngritjes në detyre për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Tregti në Shërbime" nga faza e intervistës me gojë e deri në fund të procedurës dhe atë të veprave në pajtim me dispozitat e Ligjit (të aplikuar në kohën e shpalljes së këtij konkursi) Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores të aplikuar në këtë periudhë Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1423/2023, datë 18/12/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.